



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Seanca Plenare

Seanca nr.2003/28

Prishtinë,më 16 tetor 2003,në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit Komunal të Prishtinës.

PROCESVERBAL

Seancën e kryesoi Nexhat **DACI**, kryetar i Kuvendit, kurse bashkëkryesues ishte Nafije **Gash**,anëtare e Kryesisë.

Kryetari konstatoi se në seancë ishin të pranishëm 103 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Në seancën e mëparshme ishte miratuar rendi i ditës i kësaj seance,si vijon:

1. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme;
2. Shqyrtimi i dytë i P/ligjit për pesticidet-nr.2003/26;
3. Shqyrtimi i parë i P/ligjit për sportin-nr.2003/27 dhe
4. Shqyrtimi i propozimit të panelit lidhur me kundërshtimin e koalicionit “Kthimi” në Ligjin për qasje në dokumente zyrtare.

Kryetari kërkoi nga deputetët e Kuvendit të procedohej sipas rendit të ditës të miratuar në seancën e mëparshme.

1.Miratimi i procesverbali të seancës së mëparshme.

Procesverbali i seancës të mëparshme u miratua pa vërejtje.

2. Shqyrtimi i dytë i P/ligjit për pesticidet-nr.2003/26.

Kryetari i informoi deputetët për raportet dhe për rekomandimet e komisioneve kryesore dhe të Komisionit funksional për këtë p/ligj. Ai i vuri në votim amendamentet e Komisionit për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural një veç e veç.
Kuvendi i miratoi amendamentet: 1,2,3,4,5,6,7,8,9,10,11,12,13,14,15,16,17,18,19,20 dhe 21.

Pastaj kryetari e vuri në votim P/ligjin në tërësi dhe rezultati ishte si vijon:

Për----- -të gjithë;
Kundër-----0;
Abstenime-----0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi i Kosovës, njëzëri, e miratoi Ligjin për pesticidet.

3. Shqyrtimi i parë i P/ligjit për sportin-nr.2003/27.

Kryetari e ftoi ministrin e Kulturës, Rinisë dhe të Sportit ta arsyetonte P/ligjin para deputetëve të Kuvendit.

Ministri **Behxhet Brajshori** theksoi se qëllimi i këtij P/ligji është përcaktimi i përgjegjësive të bartësve të veprimtarisë sportive. Me këtë P/ligj rregullohen menaxhimi, organizimi dhe mënyrat e ushtrimit të veprimtarisë sportive, si dhe të drejtat dhe detyrat e organizatave sportive të kësaj fushe.

P/ligji përcakton parimet themelore të ushtrimit të veprimtarisë sportive si veprimtari të interesit publik dhe mbështetjen institucionale të saj, por njëkohsisht përmban dispozita ndëshkimore për shkeljen e detyrimeve nga ana e organizatave sportive ose për mospërmbushjen e përgjegjësive që burojnë nga to.

Me këtë P/ligj promovon të drejtën për të gjithë ata që merren me veprimtari sportive, duke përcaktuar karakterin e saj, parimet e vullnetarizmit dhe të profesionalizmit, si dy kahje kryesore të ushtrimit të saj.

Në interes të qartësisë së koncepteve, rëndësi e veçantë i është kushtuar përkufizimeve themelore të nocioneve dhe këto përkufizime janë bërë në përputhje me parimet dhe standardet ndërkombëtare të sportit. Ndërsa, qëllimet dhe synimet e sportit fokusohen në nxitjen dhe në zhvillimin e sportit për të gjithë dhe institucionalizimin e tij sipas përvojave ndërkombëtare.

Kështu klubet dhe federatat e sporteve janë përkufizuar sipas parimeve dhe standardeve ndërkombëtare, me anë të të cilave do t'i zhvillojnë aktivitetet e tyre. Ndërsa, Komiteti Olimpik i Kosovës është trajtuar si organizatë më e lartë sportive joqeveritare.

Marrëdhëniet sportive me jashtë përbëjnë fushë të veçantë të këtij P/ligji.

Për shkak të rëndësisë që kanë për zhvillimin, masivitetin dhe në ngritjen e cilësisë në sport, edukimi fizik dhe sporti në shkolla dhe në universitete përbën një kapitull të veçantë të propozimligjit.

Fusha të tjera të veçanta që janë trajtuar në propozimligjin e sportit, janë: mbrojtja shëndetësore dhe financimi i sportit, përfshirë edhe mundësitë e reklamave dhe të sponsorimit të sportit.

Në fund ministri Brajshori i ftoi deputetët e Kuvendit ta miratonin këtë p/ligj.

Pas arsyetimit të këtij P/ligji nga ministri Brajshori, kryetari e hapi diskutimin për shqyrtimin në parim të këtij p/ligji.

Mevlyde Saraçi theksoi se Kosova ka nevojë imediate për këtë ligj, materia e të cilit rregullon organizimin dhe zhvillimin e veprimtarive sportive. Me këtë p/ligj ndihmohen institucionet sportive dhe individët që merren me të gjitha disiplinat sportive, si dhe përkrah pjesëmarrjen e tyre në sportin ndërkombëtarë.

Përkujdesja ndaj sportistëve duhet të precizohet veçanarisht, në mënyrë që ata të gëzojnë të drejtën e pensionit dhe të rregullohet statusi i sportistit.

Në p/ligj duhet të saktësohet se cilat organizata mund të jenë profesioniste, si dhe në çfarë niveli mund të organizojnë gara sportive. Ajo shtoi se e përkrahte në parim këtë p/ligj.

Bujar Dugolli tha se ky p/ligj i përmbush të gjitha standardet ndërkombëtare të kësaj fushe dhe duhet të përkrahet në parim, kurse gjatë shqyrtimit të tij në komisionet parlamentare ai të plotësohet. Ai theksoi se nuk duhet të ketë ndërhyrje nga Ministria apo nga Komiteti Olimpik në pjesëmarrjen e sportit të vërtet në sportin ndërkombëtar. Duhet të shfytëzohen metoda të ndryshme që sportistë kosovar të marrin pjesë në sportin ndërkombëtar, pasi sportistët tanë përfaqësojnë shtetet e huaja dhe arrijnë rezultate të mira, kurse nuk kanë mundësi ta përfaqësojnë Kosovën.

Grupi Parlamentar i AAK-së e përkrah në parim këtë p/ligj.

Lulzim Zeneli tha se ky p/ligj synon ta rregullojë një materie shumë të rëndësishme për sportin kosovar, me cilin organizohen veprimtaritë sportive në Kosovë. Me këtë p/ligj synohet të arrihet një menaxhim më i mirë veprimtarive sportive dhe t'i mundësohet sportit kosovar të jetë i pranishëm në arenën ndërkombëtare.

Grupi Parlamentar i LDK-së e përkrah në parim këtë p/ligj.

Lubomir Stanojković theksoi se si njeri që është marrë me sport dhe si anëtar i Komisionit Funkcional, e përkrah këtë p/ligj, por si pjestar i baskësisë serbe dhe si përfaqësues i koalicionit «Kthimi», nuk mund ta përkrah këtë p/ligj, ngase në të ka shumë elemente të shtetësisë. Grupi Parlamentar «Kthimi» do të abstenojë me rastin e votimit.

Ramdan Kelmendi theksoi se në këtë p/ligj duhet të numërohen edhe degët e sportit në Kosovë, mënyra e financimit dhe e aktivitetit të tyre. P/ligji duhet ta përcaktojë formën e organizimit funksional dhe qeverisës të Komitetit Olimpik të Kosovës, të Federatës së Sporteve dhe të klubeve të sporteve.

p/ligj e parasheh edhe pjesëmarrjen e sportistëve tanë në sportin ndërkombëtar, prandaj duhet të parashihet me ligj që sportistët tanë t'i kenë simbolet kombëtare dhe amblemet e tyre.

Hajredin Kuqi theksoi se ky p/ligj hyn në kuadër të përparësive për shqyrtimin dhe miratimin e ligjeve. Materia që e normon ky p/ligj u krijon shumë mundësi sportistëve dhe sportit në tërësi. P/ligji është në përputhje me Kornizën Kushtetuese dhe me dispozitat ndërkombëtare të kësaj fushe, si dhe nuk i cenon të drejtat e asnjë komuniteti në Kosovë. Grupi Parlamentar i PDK-së e përkrah në parim këtë p/ligj.

Sabit Rrustemi theksoi se Ministria duhet ta autorizojë një trup profesional për kategorizimin e sportistëve. Duhet të stimulohen federatat e sportit për nxitjen e veprimtarive sportive. Duhet të kihet një përkushtim më i madh ndaj sportistëve profesionalë, se çka mund të bëhet pas karrierës së tyre? Kjo çështje duhet të precizohet me ligj. Poashtu çështja e reklamave dhe e sponsoruesëve duhet të rregullohet me ligj. Në parim e përkrah këtë p/ligj.

Oliver Ivanoviq theksoi se me këtë p/ligj u krijohen mundësi të rinjve të merren me sport. Deri tani nuk i kushtohet kujdes i mjaftueshëm kësaj kategorie sociale dhe si pasojë e tillë, sot kemi manifestime të dukurive negative të kësaj shtrese, siç janë: përdorimi i drogës, alkoolit, duhanit etj.

Në këtë p/ligj duhet të precizohen sporti masiv, përkatësisht sporti shkollor dhe shkollat e sportit.

Në p/ligj ka shumë elemente të shtetësisë që nuk duhet të ketë. Gjatë shqyrtimit ky /ligj duhet të plotësohet me amendamente.

Gani Koci theksoi se shtetit të Kosovës i duhet një ligj që i rregullon veprimtaritë sportive. Por, nuk duhet të ndërhyhet në veprimtaritë sportive me anë të metodave administrative. Ndërhyrja eventuale e Ministrisë apo e Qeverisë në veprimtaritë sportive më së shumti mund ta dëmtojë sportin.

Kriteri më i mirë për kategorizimin e sportistëve duhet të jetë rezultati i tyre.

Në parim e përkrah këtë p/ligj.

Pas diskutimit të deputetëve, kryetari e vuri në votim këtë p/ligj dhe rezultati ishte si vijon:

Për-----shumica;
Kundër-----2;
Abstenime-----13.

Kryetari konstatoi se Kuvendi i Kosovës e miratoi, në parim, P/ligjin për sportin dhe i ngarkoi komisionet kryesore dhe Komisionin Funkcional ta shqyrtonin këtë p/ligj në afat prej tri javësh dhe t'ia paraqesin Kuvendit raportet me rekomandime për shqyrtim dhe miratim.

4. Shqyrtimi i propozimit të panelit lidhur me kundërshtimin e koalicionit «Kthimi» në Ligjin për qasje në dokumente zyrtare.

Kryetari i informoi deputetët lidhur me kundërshtimin e koalicionit «Kthimi» të këtij Ligji, si dhe për procedurat e formimit të panelit të veçantë për shqyrtimin e këtij kundërshtimi.

Paneli i veçantë, pas shqyrtimit të kundërshtimit, ia kishte propozuar Kuvendit tri amendamente për miratim, në këtë Ligj.

Hydajet Hyseni theksoi se Kuvendi mund ta marrë parasysh nenin 3 të propozuar nga paneli, i cili përfshin vërejtjet e një pjese të qytetarëve të Kosovës, por propozimi i panelit në nenin 4.1 dhe 4.2 nuk ka fare të bëjë me shkeljen e të drejtave dhe të interesave të ndonjë komuniteti në Kosovë. Ai propozoi që Kuvendi ta miratojë nenin 3, kurse të mos i miratojë nenin 4.1. dhe 4.2.

Bujar Dugolli theksoi se koalicioni «Kthimi» kundërshtimin e ka paraqitur pas afatit të paraparë me Rregullore të punës së Kuvendit.

Ai propozoi Kuvendi ta miratojë propozimin e panelit, nenin 3, kurse nenin 4.1 dhe 4.2 të mos e miratojë.

Ismajl Kurteshi tha se Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komunitetve ka konstatuar se Ligji për qasje në dokumente zyrtare nuk i cenon të drejtat dhe interesat e asnjë komuniteti në Kosovë.

Sabri Hamiti theksoi se nuk është i plotë propozimi i panelit. Kundërshtimi i «Kthimit» nuk është bërë në afatin e duhur dhe kjo nuk është konstatuar në raportin e panelit. Nëse kundërshtimi nuk është bërë në afatin e paraparë, ai nuk duhet të shqyrtohet fare.

Lilana Keniq tha se vendimet e panelit për dy çështje nuk janë marrë me koncensus. Për nenin 3.1. në parim është arritur pajtueshmëria, por nuk është miratuar propozimi i «Kthimit» që neni 3.2 të fshihet. Në propozimin e panelit për formulimin e dy neneve të reja në Ligj: neni 4.1 dhe neni 4.2 parimisht jemi dakord.

Një pjesë e propozimit të panelit për koalicionin «Kthimi» nuk janë të pranueshme.

Kryetari theksoi se në bazë të diskutimeve janë dy propozime. Ai i vuri në votim dy propozimet një nga një.

Rezultati i votimit për nenin 3 të propozimit të panelit ishte, si vijon:

Për-----shumica;

Kundër-----2.

Kundër-----2.

Kurse rezultati i votimit për nenin 4.1 dhe 4.2 të propozimit të panelit ishte,si vijon:

Për-----asnjë.

Kryetari konstatoi se Kuvendi i Kosovës e miratoi vetëm nenin 3 të propozimit të panelit në Ligjin për qasjen në dokumente zyrtare.

Seanca përfundoi në orën 11:20 minuta

Sekretaria e Kuvendit

Kryetari i Kuvendit të Kosovës

akademik **Nexhat DACI**